



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
KABINETI

URDHER

Mbi përgatitjen e akteve nenligjore në zbatim të ligjit
Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit

Nr. 23, datë 19/12 2011

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë, neni 6, pika 1 dhe pika 2 e Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit", i cili përcakton aktet që miraton Ministri i Financave në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit:

URDHEROJ;

1. Njesia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të përgatisë brenda datës **15 Tetor 2011** aktet nenligjore të parashikuara për:
 - a. Harmonizimin dhe hartimin e procedurave standarde lidhur me ndertimin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik
 - b. Perditesimin e metodologjise së kontabilitetit financiar dhe të menaxhimit për sektorin publik dhe harmonizimin e raportimit financiar me standardet nderkombetarisht të pranuar.
2. Gjatë punës së saj Njesia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të bashkëpunojë me drejtorin e tjerë të Ministrisë së Financave dhe njësi publike për hartimin e udhëzimeve të përbashkëta lidhur me procedurën specifike të fushës menaxhimit financiar dhe kontabilitetit publik.
3. Të gjitha projekt aktet ligjore dhe nenligjore që lidhen me çështje të menaxhimit financiar dhe kontabilitetit publik të dërgohen për mendim dhe aprovim paraprak dhe në Njesinë

Qendrore te Harmonizimit te Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, e cila verifikon perputhshmerine ose harmonizon aktet me procedurat standarde te miratuara me pare.

4. Ngarkohet Sekretari i Pergjithshem per ndjekjen dhe zbatimin e ketij urdhri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

RIDVAN BODE



MINISTER

